

**C**CUNGU & Co.

Zgjedhja juaj më e mirë

Ngjarje javore

**Mundësi  
të shumta  
bashkëpunimi**



# KOHA

*Favore*



9 771800 598000

Podgoricë e enjte,  
2 tetorë 2014  
Viti XIII / Numër 633  
Çmimi 0,50

[www.kohajavore.co.me](http://www.kohajavore.co.me)

**Bixhozi, problem  
për të rinjtë e Ulqinit**


Sipas rezultateve të hulumtimit të Organizatës së shoqërisë civile “Horizonti i Ri” mbi problemet dhe nevojat e të rinjve

# Bixhozi, problem për të rinjtë e Ulqinit


PIESËMARRJA E TË RINJVE NË SHOQËRI



DUKURITË MË TË PËRHAPURA NË MESIN E TË RINJVE NË ULQIN



MASAT PËR PAPUNËSINË



Rezultatet e hulumtimit të problemeve dhe nevojave të të rinjve, të cilën në periudhën qershor-gusht të këtij viti e realizoi Organizata e shoqërisë civile “Horizonti i Ri” nga Ulqini treguan se dukuria negative më e përhapur te të rinjtë në Ulqin është bixhozi.

Përveç bixhozit, hulumtimi tregoi që në mesin e të rinjve është i pranishëm depresioni dhe apatia (17%), mungesa e informimit për shëndetin riprodhues (17%), neglizhenca e të rinjve për problemet e shëndetit mendor (16%), si dhe varësia nga droga dhe dhuna (15%).

Ndër sugjerimet tjera në këtë fushë, të rinjtë veçojnë si problem të veçantë edhe praninë e kafeneve dhe bastoreve të shumta në afërsi të shkollave.

Në këtë hulumtim, të rinjtë e renditën shëndetin si fushën më të rëndësishme të tyre, pastaj arsimimin dhe punësimin. Në vend të katërt renditen familjen, pastaj të drejtat e njeriut, pjesëmarrjen në shoqëri, kulturën, kohën e lirë, informimin dhe mobilitetin.

Në fushën e arsimimit, të rinjve më së shumti iu mungojnë: kurse të gjuhëve

të huaja dhe të kompjuterëve, biblioteka më të pasura në shkolla, hapja e fakulteteve në gjuhën shqipe, më shumë drejtime në shkollën e mesme dhe në përgjithësi kushte më cilësore në arsimin formal.

Nga 174 të rinj të anketuar, 76% e tyre pohojnë se nuk arrijnë të marrin pjesë në ngjarjet që atyre iu interesojnë, ndërsa 68% e tyre nuk janë anëtarë të ndonjë klubi sportiv, shoqate apo organizate tjetër.

Anketa gjithashtu ka treguar se të rinjtë e Ulqinit janë të vetëdijshëm për shkeljet që iu bëhen të drejtave dhe lirive të tyre. Nënave të reja kryefamiljare u janë mohuar disa të drejta, sidomos e drejta e realizimit të mbështetjes së fëmijëve në të cilën ato kanë të drejtë; e drejta në punësim është e pabarabartë me meshkujt, nuk favorizohen në jetën politike, diskriminohen dhe keqtrajtohen në punë. Vajzat e reja diskriminohen edhe nga familjet e tyre, ndërsa femrat e emancipuara diskriminohen për shkak të nevojës se tyre që t’i kundërvihen traditës. Ekziston një

diskriminim dhe përjashtim i theksuar i të rinjve romë dhe egjiptianë, sidomos në përfshirjen e tyre në jetën politike dhe institucionale.

Një fushë e veçantë që paraqitet si problem i të rinjve në këtë hulumtim është papunësia. Për ta zbutur sado pak këtë problem, të rinjtë propozojnë të ndërmerren disa masa në këtë fushë: futja e orientimit profesional në shkollat (26%), masat që detyrojnë punëdhënësit për t’u siguruar të rinjve mundësi për kryerjen e praktikave (23%), programet e rikualifikimit (21%), nxitja e vullnetarizmit (15%), sigurimi i kredive të volitshme për fillestarët në biznes (15%).

Lidhur me papunësinë, të rinjtë e Ulqinit sugjerojnë se oferta e degëve të mësimin në shkollat e mesme, duhet të jetë në përputhje me nevojat konkrete të komunitetit lokal, të bëhen investime në një marketing të mirë për resurset vendore (si p.sh. ulliri dhe vaji i ulliri), të nxitet mësimi i zanateve të vjetra të cilat pothuajse janë zhdukur etj.

(Kohapress)